



**ALLAH, SA MË PASKA MARRË
MALLI PËR TË THËNË:
ERDHI RAMAZANI!**



**AGJËRIMI
NJË SHKOLLË HYJNORE**



**SELAM DO TË THOTË PAQE!
PAQE ME KË?**

UDHA ISLAME

Viti 20 - Nr. 4 (230), Prill, 2022

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

  MYFTINIASHKODER1990

RAMAZANI, MUAJI I FAMILJES

Ky është muaji i familjes; bashkë e presim, bashkë falemi, bashkë lutemi, bashkë ulemi në sofrën e syfyrit, bashkë bëjmë dhikër, bashkë argëtohemi me pak hurma e ujë para duarve, bashkë lexojmë Kuran e, sërish bashkë ulemi në sofrën e iftarit për të pritur “topin e gjyshit”, ezanin e akshamit dhe... “Allahu jua baftë kabull!”, kthehet në fjalinë më të dashur të munguar prej shumë e shumë... Elhamdulillah, erdhi!



MYFTIU: “ËSHTË RAMAZAN, EVITONI KONFLIKTET, MOS ABUZIONI ME ÇMIMET!”

Me rastin e fillimit të muajit të Ramazanit 1443, gjatë hytbes së xhumasë, më 1 prill 2022, në xhaminë e Parrucës ka apeluar për paqe e mirëkuptim, bamirësi dhe solidaritet në mes njerëzve si dhe për ngritje të vetëdijes fetare dhe identitare në shërbim të së mirës, të respektit të trashëguar me shekuj dhe të barazisë sociale dhe komunitare.



“Ky është muaji në të cilën jemi të ftuar drejt bamirësisë dhe harmonisë, jo drejt kacafytjes...”

(f. 3)

IFTARET E VËLLAZËRISË ISLAME NË OBORRIN E XHAMISË PARRUCË

Një traditë e bukur i shtohet sivjet atmosferës së Muajit Ramazan në Shkodër. Iftaret e vëllazërisë islame do të zbukurojnë qendrën e qytetit Shkodër në këto netë të bekuara të Muajit të shenjtë.



Falë punës së palodhur të imamëve të xhamisë Parrucë, teologëve Durim Kasemi dhe Naim Drijaj, si dhe mbështetjes së bamirësve shkodranë, Myftinia Shkodër vlerësoi propozimin për të zhvilluar iftaret e hapura, syfyret...

(f. 14)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

SA MË PASKA MARRË MALLI PËR TË THËNË: ERDHI RAMAZANI!

Ky është muaji i familjes; bashkë e presim, bashkë falemi, bashkë lutemi, bashkë ulemi në sofrën e syfyrit, bashkë bëjmë dhikër, bashkë argëtohem me pak hurma e ujë para duarve, bashkë lexojmë Kuran e, sërish bashkë ulemi në sofrën e iftarit për të pritur “topin e gjyshit”, ezanin e akshamit dhe... “Allahu jua baftë kabull!”, kthehet në fjalinë më të dashur të munguar prej shumë e shumë... Elhamdulillah, erdhi!

Erdhi Muaji Ramadan, çdo gjë gëzon, drita është simbol i tij, kandili ndriçon e fytyrat qeshen!

Ky është muaji i familjes; bashkë e presim, bashkë falemi, bashkë lutemi, bashkë ulemi në sofrën e syfyrit, bashkë bëjmë dhikër, bashkë argëtohem me pak hurma e ujë para duarve, bashkë lexojmë Kuran e, sërish bashkë ulemi në sofrën e iftarit për të pritur “topin e gjyshit”, ezanin e akshamit dhe... “Allahu jua baftë kabull!”, kthehet në fjalinë më të dashur të munguar prej shumë e shumë... Elhamdulillah, erdhi!

Ky është muaji i ndezjes së kandilave të bamirësisë e bujarisë, përkushtimit e fetarizmit të dëshmuar në fshehtësi, si nijeti i agjërimit dhe ndjesitë e tij, por edhe haptaz, si buzëqeshjet, fjalët

e ëmbla, hapat drejt xhamisë, puna me sakrificë e ndershmëri dhe lutjet me xhemat në ditët e tij...

Ky është muaji i shpresës, i mëshirës dhe faljes, i adhurimit dhe pendimit, i kthimit nga namazi dhe leximi, i veshjes së hixhabit dhe heqjes dot nga shumë prapësi, me të njëjtin nijet, si ai i agjërimit të ditës së parë, edhe asaj që pason..., edhe të mrames ditë të Ramazanit..., deri në frymën e dorëzimit të amanetit tek Zoti i tij...

Ky është muaji i llogarive me veten. “A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e Allahut dhe me atë të vërtetën që zbriti (me Kuran)...”?

Vërtetë, a nuk është koha për një pushim? Boll me stërmundime e lodhje pas kësaj bote! Boll i vetëm, pa

mbështetjen e përmendjes së Zotit e pa dritën e Tij! Boll me drita artificiale e udhërrëfyes të kopjuar keq, si ciceron i fjetur në këtë udhëtim të jetës së papërcaktuar!

Boll me hutim! Unë e kam akoma një mundësi! Zoti im nuk më ka braktisur! Zoti im po më pret...! Ky Muaj, është pikërisht mundësia më e mirë! Ky Muaj, le të jetë fillimi..!

Është Ramazan, është ripërtëritje e gjallërim! Është rimëkëmbje e kthim në origjinë! Është bekim e thirrje që gëzon qiej e tokë, që zbukuron me pastërti sipërfaqen e tokës, larë me ujë sihariqesh nga lartësi të pamatura...

Erdhi Ramazani, o njerëz!

Allah, sa më paska marrë malli për të thënë: Erdhi Ramazani!

Shkodër, më 2 prill 2022



MYFTIU: “ËSHTË RAMAZAN, EVITONI KONFLIKTET, MOS ABUZONI ME ÇMIMET!”

“Ky është muaji në të cilën jemi të ftuar drejt bamirësisë dhe harmonisë, jo drejt kacafytjes, përçarjes dhe asaj që na largon nga mirësia e Zotit. Ta ruajmë edhe ta shenjtërojmë bukurinë dhe madhësinë e muajit të madhërueshëm të Ramazanit!”

Me rastin e fillimit të muajit të Ramazanit 1443, gjatë hytbes së xhumasë, më 1 prill 2022, në xhaminë e Parrucës ka apeluar për paqe e mirëkuptim, bamirësi dhe solidaritet në mes njerëzve si dhe për ngritje të vetëdijes fetare dhe identitare në shërbim të së mirës, të respektit të trashëguar me shekuj dhe të barazisë sociale dhe komunitare.

“Ky është muaji në të cilën jemi të ftuar drejt bamirësisë dhe harmonisë, jo drejt kacafytjes, përçarjes dhe asaj që na largon nga mirësia e Zotit.

Cilido prej nesh që për hatër të këtij muaji të madhëruar të Ramazanit, duke qenë agjërueshëm, edhe ata që nuk janë agjërueshëm, por që frenohen nga zënkat e nga zhurmat e panevojshme, Allahu i begatoftë dhe i lartësoftë me të mira në këtë botë dhe në tjetrën!”

Më herët, në dersin e xhumasë, Myftiu solli në vëmendje edhe një detaj nga e kaluara e afërt, ku përmendi se: “Rrëfimet dhe dëshmitë e gjyshërve tanë që thonin se gjatë muajit të madhërueshëm të Ramazanit në Shkodër, edhe të krishterët nuk kanë ngrënë e as nuk kanë pirë në mënyrë të ekspozuar, si respekt ndaj agjërimit të muslimanëve.

Njerëzit në këtë qytet, muslimanët dhe të krishterët ia kanë kushtuar njëri-tjetrit respektin ndaj shenjtërive të njëri-tjetrit, pra mos të bëhet sot muslimani prishës i këtij tabani.

Ta ruajmë edhe ta shenjtërojmë bukurinë dhe madhësinë e muajit të madhërueshëm të Ramazanit!”, tha Myftiu.

Gjithashtu, theksoi se ky muaj është rast i volitshëm i shtrirjes së ndihmës ndaj atyre që kanë nevojë, në veçanti të varfërve dhe skamnorëve, sikundër u bëri thirrje autoriteteve shqiptare dhe biznesit që në këtë situatë të vështirë ekonomike të ulin çmimet dhe të mos abuzojnë me krizën aktuale me të cilën po përballet shoqëria shqiptare.

“Allahu (xh.sh) do nëpërmjet këtij muaji të begatë të Ramazanit të na lartësojë drejt dashurisë së Tij, mëshirës dhe faljes së pakufishme, për t’u kthyer pas këtij muaji të begatë gjithsecili si një element garancie, sigurie, zhvillimi dhe përparimi në shoqërinë e tij.

Një shoqëri në të cilën njerëzit e saj, besimtarët e saj agjërojnë Ramazanin nuk mund të jetë kurrë një shoqëri e varfër dhe nuk mund të jetë kurrë shoqëri e prapambetur, e korruptuar, e

pandershme, në të cilën rriten çmimet në mënyrë abuzive dhe përplasen elitat e kombit, e në të cilën njerëzit janë të pasigurt dhe nuk dinë se çfarë bëhet nesër.

Jo të dashurit e mi! Në shoqërinë e agjërimit të Ramazanit jemi të gjithë të ftuar për të bërë më të mirën dhe për t’i dëshmuar Allahut më të mirën nga vetja jonë, për të dëshmuar vlerat dhe për të përhapur elementet e begata të këtij muaji të shenjtë në çdo vend dhe me çdo njeri.

Kjo është për tregtarët dhe për politikën në veçanti, që të distancohen dhe të largohemi të gjithë së bashku në këtë muaj të begatë të Ramazanit nga zënkat e pakuptimita, nga rritja e çmimeve abuzive.

Ky është muaji në të cilën duhet të ulen çmimet për hatër të Zotit e për të mirë të shoqërisë sonë shqiptare dhe për të mirën e njëri-tjetrit, sepse jemi vëllezër në këtë tokë, e nën këtë qiell të Zotit”, ka thënë ndër të tjera Myftiu Sytari, i cili në fund të mesazhit të tij, u lut për një Ramazan të begatë, me zemër të mirë dhe me agjërime të pranuar nga Krijuesi i gjithë njerëzisë, Allahu (xh.sh).





Dr. Ajni Sinani
Studiues islam, Prizren

AGJËRIMI NJË SHKOLLË HYJNORE

shpërblimi dhjetëfish e më shumë, kurse agjërimi është i Imi dhe Unë do të shpërblejë për të (në mënyrë të veçantë)."

Fillimi i tij është mëshirë, mesi i tij falje prej gjynaheve, dhe fundi lirim nga dënimi i zjarrit.

Në këtë muaj Allahu ofron favore dhe shpërblime të shumta për agjëruarit.

Secili individ duhet të përgatitet që ta shtojë intensitetin e ibadetit të tij, dhe t'i pakësojë sa më shumë shprehjet dhe veset e këqija. Gjatë Ramazanit kalitet shpirti dhe trupi, prandaj ai konsiderohet një shkollë hyjnore ku individ dhe shoqëria pajisen me mësimet e tij të vlefshme, sikurse janë: bindja, vullneti, këmbëngulja, qëllimi fisnik, pastrimi i vetes dhe sinqeriteti. Ai është lartësim i shpirtit dhe ngritje drejt dëlirësisë.

Agjërimi është një gjendje e veçantë dhe përmbajtje jo vetëm nga ushqimi e pija, duhani, marrëdhëniet intime, por edhe nga shpifja, gënjeshtria, shikimi i ndaluar, si dhe nga çdo gjynah. Prandaj, agjërimi më shumë duhet të ndihet me zemër dhe shpirt, sesa të njihet dhe kuptohet me logjikë e arsye.

Vlera dhe rëndësia e Ramazanit ngërthen jo vetëm aspektin fetar dhe moral, por edhe atë social.

Agjërimi i kuptuar drejt si një institucion social zhvillon altruizmin dhe dashurinë te njeriu, dhe edukon ndjenjën e vetëmohimit dhe sakrifikimit. Islami dëshiron të ndërtojë një njeri që sakrifikon të mirat materiale dhe jetën e tij për të mirën e shoqërisë.

Në kohën tonë vlerat morale janë degraduar, kurse pasurimi me çdo kusht, pavarësisht nga përzgjedhja e mjeteve, është bërë qëllimi kryesor i jetës. Nga urtësitë e agjëritit është që

i pasuri të ndiejë urinë me të varfrin dhe të kuptojë vlerën e mirësive dhe pasurisë që i është dhuruar, dhe të tregohet mirënjohës ndaj Allahut duke i ndihmuar njerëzit që janë të nevojshëm.

Muhamedi (a.s) ka thënë: "Nuk është mysliman i vërtetë ai që ka barkun plot, kurse fqinji përkrah tij është i uritur." Shoqëria që nuk i respekton këto vlera digjet në flakën e ndasive të saj klasore si rezultat i korrupsionit, padrejtësisë dhe amoralitetit.

Të gjithë myslimanët gjatë këtij muaji janë më të devotshëm, më dorëlibër dhe më modestë.

Prandaj, është e nevojshme që jeta e njeriut t'i nënshtrohet ligjit moral dhe të zgjojë ndjenjën sociale te njerëzit, që të zbutet varfëria dhe uria. Shoqëria islame nuk guxon të ketë mjerim social dhe dallime klasore.

Pejgamberi (a.s), edhe pse gjatë gjithë kohës ka qenë njeri më bujar, megjithatë gjatë Ramazanit bujaria dhe fisnikëria e tij manifestohej edhe më shumë. Sahabët, për mirësinë e tij gjatë muajit Ramazan, kanë thënë se ka qenë "më me bollëk se mirësia e erës që sjell shiun e begatshëm".

Shoqëria jonë sot ballafaqohet jo vetëm me varfëri ekonomike, por po përjeton edhe mjerim të madh moral. Kultura dhe tradita fetare që e kanë mbajtur familjen të shëndetshme dhe e kanë mbrojtur nga ndikimi i kulturave të huaja dhe nga infektimi i dukurive negative kanë filluar të zbehen, dhe sot asaj i kanoset rreziku i shthurjes dhe zvetënimit. Ramazani është rast i volitshëm që të evitojmë çdo gjë që është në kundërshtim me mësimet islame dhe që zbeh vlerat e mirëfillta në familjet tona.

Agjërimi është një gjendje e veçantë dhe përmbajtje jo vetëm nga ushqimi e pija, duhani, marrëdhëniet intime, por edhe nga shpifja, gënjeshtria, shikimi i ndaluar, si dhe nga çdo gjynah. Prandaj, agjërimi më shumë duhet të ndihet me zemër dhe shpirt, sesa të njihet dhe kuptohet me logjikë e arsye.



Naim Driaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëllartë në lidhje me agjërimin e muajit të Ramazanit ka folur vetëm në suren el-Bekare, në ajetet 183-186.

1. Allahu i Madhëruar ka përzgjedhur që të na thërrasë në këtë mënyrë: "O ju që keni besuar!" Nga tërësia e emërtimeve të shumta që Allahu (xh.sh) mund të përzgjidhte për ne Ai përzgjedhi shprehjen "O ju që keni besuar." Prandaj ne duhet të dëshmojmë se meritojmë të quhemi: "Besimtarë".

2. Radhitja me ata burra (Pejgamberët) që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në histori: "Agjërimi është bërë obligim për ju, sikur ka qenë edhe për ata që ishin para jush."

3. Arritja e devotshmërisë: "Me qëllim që të ruheni (nga gjynahet) dhe të arrini devotshmërinë."¹ Nga ana gjuhësore, fjala "Takva" ka disa kuptime: "Ruajtje, mbrojtje, etj." Mbrojtje ndaj rreziqeve të caktuara, si p.sh: gjynahet, devijimi, pasimi i epshit, etj. I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Agjërimi është mburojë..."² Me agjërim njeriu arrin të mbrohet dhe të ruhet nga gjynahet.

4. Ditë të numëruara: Allahu (xh.sh)

1. Kur'ani, El-Bekare: 183.
2. Transmetuar nga Imam Ahmedi dhe Bejhaku.

MËSIMET NGA AJETET E AGJËRIMIT

thotë: "Agjërimi është për një numër të caktuar ditësh."³ Sikur agjërimi të ishte i vazhdueshëm, do ishte diçka e vështirë për t'u kryer nga ne.

5. Allahu e privilegjoji muajin e Ramazanit me zbritjen e Kur'anit dhe ai konsiderohet si muaji i tij: "Ramazani është muaji në të cilin ka zbritur Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe kriter dallues (i së vërtetës nga e kota)."⁴ Ka transmetime nga Pejgamberi (a.s) se të gjithë librat e shenjtë kanë zbritur në muajin e Ramazanit, domethënë sa herë Allahu ka dashur që të udhëzojë ose të ndryshojë një popull, ka përzgjedhur që pikënisja e këtij ndryshimi të jetë muaji i Ramazanit.

6. Allahu (xh.sh) me obligimin e agjëritit dëshiron për ne lehtësim e jo vështirësim: "Allahu dëshiron për ju lehtësimin. Ai nuk dëshiron vështirësinë për ju."⁵ Allahu nuk na ka rënduar në fenë e Tij me diçka që ne nuk kemi mundësi për ta zbatuar.

7. Falënderimi dhe mirënjohja ndaj Allahut (xh.sh): "Allahu kërkon nga ne që të bëhemi mirënjohës dhe ta falënderojmë Atë."⁶

Sa jemi mirënjohës për begatitë e Allahut, të cilat i shfrytëzojmë në këtë botë? Allahu i Lartësuar thotë: "Në vetet tua, a nuk shihni vallë?"⁷

Përse falënderimi në ajetet e agjëritit?

Me e falënderuar Allahun e Lartësuar që na e ka bërë obligim agjërimin për të fituar sa më shumë shpërblime dhe mirësi.

Nëpërmjet agjëritit, Allahu i

3. Kur'ani, El-Bekare: 184.
4. Kur'ani, El-Bekare: 185.
5. Kur'ani, El-Bekare: 185.
6. Kur'ani, El-Bekare: 185.
7. Kur'ani, Edh-Dharijat: 21.

Madhëruar na tregon se çfarë do të thotë të të mungojnë dhuntitë. Prandaj kërkohet nga ne që ta falënderojmë vazhdimisht Atë.

Me e falënderuar Allahun ngase i ka liruar disa (si të sëmurin, udhëtarin, gruan shtatzënë, etj) nga detyrimi i agjëritit.

Me e falënderuar Allahun, që na e dha mundësinë dhe ndihmën për ta agjëruar këtë muaj.

8. Vlera dhe rëndësia e lutjes. Allahu (xh.sh) thotë: "Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër (tyre); I përgjigjem lutjes, kur lutësi më lutet."⁸ "Ne jemi më afër tij se damari i qafës së vet."⁹ Në kuadër të ajeteve të agjëritit, Allahu i Madhëruar ka vendosur këtë ajet që nuk ka të bëjë me agjërimin, rregullat e tij dhe as me muajin e Ramazanit.

Përse Allahu e ka vendosur këtë ajet në ajetet e agjëritit? Sepse ky ajet është i kushtëzuar me ne. "Le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë vetëm Mua, që të udhëzohen në rrugën e drejtë!"¹⁰

Nëse ne i përgjigjemi thirrjes së Allahut "O ju që keni besuar", Allahu na premtan që ka për t'iu përgjigjur lutjeve tona. "M'u lutni Mua, Unë t'ju përgjigjem!"¹¹

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Me të vërtetë, për çdo musliman në çdo ditë dhe natë në Ramazan ka një lutje të pranuar."¹² "Agjëruarit nuk i refuzohet lutja në kohën e iftarit."¹³ Ky hadith i Pejgamberit (a.s) na nxit që t'i shpreshtojmë lutjet tona në Ramazan, e në veçanti para iftarit.

8. Kur'ani, El-Bekare: 186.
9. Kur'ani, Kaf: 16.
10. Kur'ani, El-Bekare: 186.
11. Kur'ani, Gafir: 60.
12. Transmetuar nga Imam Ahmedi.
13. Ahmed Shakir, Umdetu Et-Tefsir, 1/225.



MYFTIU I SHKODRËS, NË MESIN E BESIMTARËVE NË BIENNE, LOZANË DHE GJENEVË



Me ftesë të Qendrës Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Lozanë të Zvicrës dhe kryetarit të saj, Mr. Fehim ef. Abazi, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ligjëroi në disa xhami shqiptare të Zvicrës, në datat 8-11 prill 2022.

Fillimisht në xhaminë "Ebu Bekër", të Komunitetit Shqiptar Mysliman në Biennë, pastaj në Qendrën Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Lozanë dhe më pas në xhaminë "Dituria" në Gjenevë, Myftiu ligjëroi rreth temave që lidhen me konceptin e kohës në Islam, marrëdhënien e sotme me Kuranin dhe modelin e besimtarit të përkufizuar në Kuran, në raport me jetën dhe tjetrin.



Gjatë kësaj vizite të begatë, Myftiu zhvilloi takime të përzemërta me të nderuarit: H. Emin Odai (Bienne), Mr. Fehim Abazi (Lozanë), H. Rijad Aliu (Gjenevë), sikurse ligjëroi së bashku me të nderuarin Dr. Qani Nesimi (Myfti i Tetovës), etj.

Një moment i veçantë i kësaj vizite ishte takimi i përzemërt dhe bashkëbisedimi i gjatë me dy nxënës të hershëm të Hoxhës së madh shqiptar, H. Vehbi S. Gavoçi, të nderuarit Hoxhë Irfan ef. Abazi dhe Hoxhë Hamdi ef. Aliu.

Gjatë qëndrimit në Zvicër, Myftiu pati mundësi të shihte edhe arritjet e veçanta të qendrave islame shqiptare në disa qytete, si dhe përkushtimin e theksuar të imamëve dhe këshillave të xhamive në Zvicër.



SHOQATA BAMIRËSE "VATAN", PRANË BESIMTARËVE TË MYFTINISË SHKODËR



Paraditën e së hënës, më 25 prill 2022, Myftinia Shkodër, në bashkëpunim me Shoqatën Bamirëse "VATAN" në Zvicër, mundësoi shpërndarjen e mbi 50 pakove ushqimore për banorët e fshatit Omaraj në Postribë.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, i cili shfrytëzoi rastin për të shprehur falënderimet dhe mirënjohjen e thellë për Sh.B. "VATAN", në Zvicër dhe vëllezërit që e drejtojnë, nëpërmjet përkushtimit të cilëve, banorët e zonës së Omarajve në Postribë, u furnizuan me ndihma ushqimore, në prag të Natës së Kadrut.

Vlen të përmendet se banorët e Omarajve jetojnë thuajse të izoluar për shkak të mungesës së rrugës së shtruar dhe një ure lidhëse me rrugën e fshatit Ura e Shtrenjtë, për të cilat Myftinia Shkodër apelon qeverinë shqiptare dhe Bashkinë Shkodër, pasi gjendja e këtyre banorëve është jashtë çdo logjike urbane të vitit dhe shekullit në të cilin jetojmë.

Gjatë kësaj vizite në Omaraj, Myftiu vizitoi edhe xhaminë, e cila ka nevojë për disa meremetime dhe mbi të gjitha për minaren dhe një objekt shtesë në shërbim të rinisë dhe xhematit.

Myftiu falënderoi edhe angazhimin plot përkushtim të imamit të kësaj xhamie, të nderuarit, H. Fatmir Bushaj.



MYFTIU I SHKODRËS DREJTOI LUTJET E NATËS SË KADRIT NË MESIN E BESIMTARËVE NË XHAMINË E WILIT, ZVICËR



Gjatë datave 27-28 prill 2022, me ftesë të Qendrës Islame Shqiptare në Wil të Zvicrës dhe imamit të saj, Mr. Bekim ef. Alimi, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në aktivitet e Natës së Kadrut, të zhvilluara në xhaminë e re të bashkësisë islame shqiptare të këtij qyteti në rajonin e St. Gallenit.

Myftiu mbajti ligjërata, zhvilloi takime me vëllezër e miq të ardhur edhe

nga qytete të tjera dhe drejtoi lutjet e Natës së Kadrut, sikurse iu përgjigj edhe pyetjeve të ndryshme të besimtarëve të interesuar.

Ai falënderoi imamin e zellshëm, Mr. Bekim ef. Alimi dhe kryesinë e xhamisë së Wilit për ftesën bujare, për mikpritjen dhe frymën e bashkëpunimit dhe hapjes me të tjerët, që dëshmohej dukshëm në aktivitetin e larmishëm të kësaj qendre islame të mirënjohur në Zvicër.



KTHIMI I XHEMATEVE PËR TERAIV, BEKIM DHE GËZIM!

Me shfaqjen e hënës së re të Ramazanit 1443, akshamin e të xhumasë, më 1 prill 2022, zyrtarisht hymë në atmosferën e begatë të Muajit të begatë.

Besimtarë të shumtë mbushën xhamitë për faljen e teravisë së parë, të gjithë së bashku, duke përjetuar emocione e bekime të ndjera.

Xhamitë e zbukuruara nga brenda dhe jashtë, janë dëshmia më e mirë se ky Muaj ka ardhur me mirësi e mëshirë, me bekime e begati për të gjithë.



Nga xhamia e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, uroi besimtarët duke shprehur emocionet e natës së parë të Ramazanit të këtij viti, agjërimi i të cilit nisi sot, të shtunën, më 2 prill 2022.

Myftiu kujtoi të shkuarën e afërt dhe mundësitë e para 30 viteve, si dhe komoditetet e sotme që ofrojnë xhamitë për kryerjen e adhurimeve me qetësi e prehje.

Falënderoi angazhimin e imamëve të dashur dhe risitë e bukura që do të jenë pjesë e këtij Muaji, duke angazhuar faktorë të shumtë në qytet e fshat për të përjetuar një atmosferë sa më të këndshme e shpirtërore.

Po ashtu falënderoi hafizët nga Turqia, që sivjet kanë ardhur për të qenë me ne gjatë aktivitetit të teravisë, hatmes, por jo vetëm.

Atmosfera e këtij Muaji dritësoi krejt lagjet dhe fshatrat, duke dëshmuar forcën e besimit dhe paqen e zemrave të përmalluara për këtë shpirt!

Muaji Ramazan nisi me bekime dhe gëzim, plot dritë e pastërti! Me zemër të mirë!





Evans Drishti

SELAM DO TË THOTË PAQE! PAQE ME KË?

jo vetëm kur “të zë halli”, por në çdo rrethanë,

Të kujdesesh të mbash në formë jo vetëm fizikun tënd, por veçanërisht kujtesën, mendjen dhe inteligjencën tënde...

Të bësh paqe me mjetet shkollore që do të thotë:

Të tregohesh i kujdesshëm me çantën e shkollës

T'i trajtosh me rregull dhe disiplinë librat e shkollës, jo t'i shfletosh me ashpërsi dhe vrazhdësi, përkundrazi me shumë finesë dhe delikatesë.

Të dish ti përdorësh me shumë kujdes mjetet e punës, lapsin, stilolapsin, gomën, fletoret, vizoret, rrigat...

Të kujdesesh për uniformën e shkollës duke mos e hedhur tutje si të ishte një leckë, përkundrazi duke u përkujdesur me shumë finesë për të edhe për shkak të simbolikës që ajo mbart,

Të mos zhgarravitësh “kot së koti” fletoren apo librin, por ta ruash dhe të kujdesesh që të mbash vetëm shënime të duhura dhe të vlefshme për mësimin,

Të mos zhgarravitësh bankën ku ulesh apo edhe karrigen, thjesht sa për të kaluar kohën apo për inatin e ndokujt, por ta ruash si një orendi me vlerë që të shërben në çdo kohë.

Të bësh paqe me tjetrin do të thotë:

Ta përshëndesësh tjetrin me një buzëqeshje paqësore dhe fisnike

Të komunikosh me prindërit, familjarët me shumë përzemërsi

Të bashkëbisedosh me shokët e

klasës dhe të shkollës me shumë respekt dhe ngrohtësi, të kuptosh se duhet ti duash dhe ti vlerësosh, ti respektosh, ti kuptosh, ti trajtosh si qenie njerëzore me shumë vlerë për ty dhe jetën, por jo të abuzosh ...

Të bashkëbisedosh me mësuesit, drejtuesit e shkollës apo edhe me çdo person që është më i madh në koshë, jo vetëm për respekt, por edhe për intelektualitetin që shfaqin,

Të kuptosh se çdonjëri ka një “natyrë të posaçme” që duhet vlerësuar

Të kuptosh se çdo fjalë e thënë ndaj tjetrit duhet peshuar dhe menduar mirëfiltazi para se të nxirret nga goja për të kuptuar edhe efektin që do të sjellë më pas

Të gjykosh se çdo veprim duhet peshuar mirë në mënyrë që mos të lëndojë tjetrin duke i thyer edhe zemrën,

Të kuptosh se “hakmarrja” është një veprim i turpshëm dhe që duhet dënuar në të gjitha dimensionet e veta,

Të pranosh se në shkollë nuk shkohet për t'u bërë “hero” i klasës apo i shkollës nëpërmjet ashpërsisë dhe vrazhdësisë apo edhe arrogancës, përkundrazi për t'u bërë një model i vlerave njerëzore,

Të kuptosh se nuk të ben “njeri i fuqishëm” përdorimi i fjalëve apo shprehjeve vulgare, por një sjellje e hijshme që në thelb synon dashamirësinë dhe urtësinë njerëzore,

Të bësh paqe me mjedisin do të thotë:

Të përkujdesesh për ambientin ku rri dhe kalon përditshmërinë tënde

Të tregohesh i gatshëm dhe me sy

estetik për mirëmbajtjen e çdo këndi, në dhomën tënde, në shtëpi, në oborrin e shtëpisë, në klasë, në bankën tënde, në korridorin e shkollës, në oborrin e shkollës, në rrugicën e lagjes, në rrugët e qytetit ...

Të kujdesesh dhe të aktivizohesh për gjelbërimin e vendit ku jeton,

Të ndërmarrësh nisma që i shërbejnë zhvillimit të ambientit dhe për rrjedhojë edhe emancipimit tënd,

Të bësh paqe me librin do të thotë:

Të përkujdesesh për mirëmbajtjen e librave shkollorë

Të lexosh me vemëndje dhe kujdes librat e shkollës dhe ato jashtëshkollor

Të përpiqesh të kuptosh çdo gjë që është shkruar dhe trajtohet në libra me synimin e qartë se çdo fjalë ka një peshë me vlerë dhe është vënë për të të thënë diçka, dhe për rrjedhojë të të transmetojë një mesazh jetik,

Të kuptosh se çdo libër që të ofrohet kërkon të të japë udhëzime me vlerë për rrugëtimin tënd të gjatë,

Të kuptosh se çdo fjalë dhe fjali përbën një dritare që të ofron një vizion të ri për “atë që je” dhe “atë çfarë do të bëhesh” në të ardhmen,

Të kuptosh se urdhëri i parë hyjnor është “Lexo! Në emër të Zotit tënd!” dhe se çdo gjë kalon vetëm dhe vetëm përmes “leximit”,

Të kuptosh se pa një “lexim” të vemendshëm dhe të kuptueshëm, pa një “lexim” të qartë dhe të rregullt, pa një “lexim” të mirëmenduar dhe të arsyetueshëm s'mund të kuptosh peshën e fjalës dhe për rrjedhojë edhe arsyen përse je “një nxënës”, “një prind”, “një mësues”, “një drejtues”, “një mjek”, “një inxhinier”, “një arkitekt”, “një teolog”, pra “një njeri”...

Shumë të shtrenjët prindër!

Në kohën e zhvillimit marramendës të teknologjisë është koha që tregoheni të paqtë me çdo gjë të fëmijës tuaj:

Tregohuni të vemendshëm t'i përshëndesni fëmijët tuaj që në mëngjes, jo sa për të kryer “adetin”, por që ta kuptoni në sy se me ç'natyrë dhe dëshirë do të fillojë ditën qenia juaj e jetës,

Jetojeni me të çdo emocion të përditshmërisë, bashkë të përgatiteni për shkollë, bashkë të ushqeheni në mëngjes, bashkë të përgatisni çantën e shkollës, bashkë t'u jepni kuptim arsyeve dhe arsyetimeve të larmishme,

Të uleni së bashku “të lexoni” dhe “të mësoni”, pasi vetëm në këtë mënyrë do të bëheni pjesë e botës së tij duke mos hasur asnjë vështirësi në perceptimin e botëkuptimit të tij,

Të luani bashkë me të, jo thjesht ta “ndrydhni” në dhomë me idenë se “ua krijuat tërë kushtet”, pasi në të vërtetë s'keni plotësuar kushtin më të rëndësishëm, atë të “paqësimit” me shpirtin e tij,

Të diskutoni bashkë edhe për ato tema, të cilat juve mund t'ju duken “tabu”, pasi vetëm në këtë mënyrë i fitoni zemrën dhe mëndjen duke hedhur themelet e një “sigurie” dhe një “paqeje” shumë të dëshirueshme,

Të shëtitni bashkë, jo thjesht të uleni në një kafene, por të kuptoni se një “shëtitje” në këmbë apo me makinë në një ambient ndryshe do e bëjë më të çlirët atë dhe për rrjedhojë edhe ju...

“Lexoni” bashkë me të gjëra të bukura dhe tërheqëse që shënojnë padyshim edhe një kthesë në memorien e tij, mos ia lehtësoni punën vetes duke i ofruar “telefonin” si një “rrugëzgjdhje” e vyer për ju dhe për të,

Kuptoni hapat e zhvillimit të fëmijës tuaj dhe mos harroni se “kjo qenie” është trashëgimi e aftësive dhe prirjeve tua, që jo domosdoshmërisht duhet të jenë të njëjta.

Është koha të tregohemi të paqtë me të shkuarën tonë të afërt apo të largët,

Me të gjithë ata që ndërtuan me shumë mundim dhe sakrificë gjeneratën tonë familjare dhe farefisnore

Me të gjithë atë plejadë edukatorësh dhe arsimtarësh, mjekësh, arkitektësh, inxhinierësh, të pasionuarit pas zanatave plot vlerë që na përcollën deri në këto ditë këto vlera të traditës dhe kulturës, këtë trashëgimi me të cilën sot krenohemi,

Me të gjithë atë plejadë dijetarësh që na lanë gjithë ato thesare librash të fushave të jetës me të cilat sot zhvillohemi dhe integrohemi me ritme të shpejta,

Bota sot kërkon “paqe” në vend të “luftës”, kërkon “harmoninë” në vend të “ngatërresës”, kërkon “moral”, në vend të “imoralitetit”, kërkon “ndershmëri” dhe “drejtësi”, në vend të “korrupsionit”, kërkon “ndjeshmëri” në vend të “indiferencës”, kërkon “njeriun lexues” në vend të “fodullëkut” ...

Paqja qoftë mbi ju!

Paqja qoftë mbi të gjithë ne!

HATMEJA E RAMAZANIT, NJË TRADITË E PËRVITSHME NË SHKODËR



Tradita e vjetër e Hatmes Sherife të Kuranit Famëlartë, nisi edhe për këtë Muaj Ramazani, në drejtimin e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe imamëve të nderuar, në prani të besimtarëve besnikë të këtij adhurimi të spikatur e të kërkuar në Ramazan.



Myftiu solli në vëmendje të besimtarëve se Muaji Ramazan është mundësia më e mirë për t'u përkushtuar ndaj Kuranit, mësimi dhe përvetësimit të tij, tamam siç vepronte edhe Resulullahu (a.s) që e bënte çdo Ramazan nga një hatme me Xhibrilin (a.s).

Tradita e bukur e mbledhjes në xhami për ta lexuar të plotë Kuranin Famëlartë është një mundësi e mirë për të kaluar një orë të begatë në shoqërinë e Fjalës së Allahut dhe mesazheve që marrim prej Tij.



KAZAKISTANI OSE REPUBLIKA E KAZAKISTANIT

Kazakistani, ose zyrtarisht 'Republika e Kazakistanit', është një vend transkontinental, i vendosur kryesisht në Azinë Qendrore, dhe pjesërisht në Evropën Lindore. Ai kufizohet me Rusinë në veriperëndim dhe në veri, me Kinën në lindje, me Kirgistanin, Uzbekistanin, Detin Aral dhe Turkmenistanin në jug, kurse në jugperëndim Kazakistani kufizohet me Detin Kaspik.

Kazakistani është vendi më i madh në botë me shumicë myslimane për nga sipërfaqja tokësore, gjithashtu edhe më veriori i vendeve muslimane. Siç është vendi më i madh në Azinë Qendrore, dhe i nënti më i madhi në botë.

Kazakistani ka një popullsi prej 19.184.486 banorësh (1), dhe një sipërfaqe prej 2.724.900 km².

GJEOGRAFIA

Kazakistani shtrihet në të dyja anët e lumit Ural, lum i cili konsiderohet si vija ndarëse që ndan Evropën dhe Azinë, kështu që, Kazakistani është një nga dy vendet e vetme pa dalje në det, në botë, që janë transkontinentale (shtrihen në dy kontinente, dhe vendi tjetër është Azerbajxhani).

Ultësirat përbëjnë një të tretën e hapësirës së madhe të Kazakistanit, pllajtat kodrinore dhe rrafshnaltat përbëjnë gati gjysmën, dhe rajonet e ulëta malore rreth një të pestën. Pika më e lartë e Kazakistanit, Kan-Tengri, arrin në 6.995 metra, në vargmalin Tien Shan, në kufirin mes Kazakistanit, Kirgistanit dhe Kinës. Kjo lartësi bie në kontrast me terrenin pothuajse të sheshtë të pjesës më të madhe të kësaj republike. Pjesët perëndimore dhe jugperëndimore të Kazakistanit dominohen nga Ultësira e Detit Kaspik, e cila në pikën e saj më të ulët shkon në rreth 28 metra në nivelin e detit. Në jug të Ultësirës së Kaspikut, gjenden Pllaja Ustiurt dhe Gadishulli Tupkaragan, e cila del në Detin Kaspik. Sasi të mëdha rëre formojnë shkretëtirat Barsuki i Madh dhe Karakumi Aral (pranë Detit Aral), shkretëtirën e gjerë Betpakdala (në brendësi të vendit), dhe shkretëtirat Mujunkum dhe Kizilkum (në jug). Shumica e këtyre rajoneve shkretinore mundësojnë një shtresë të lehtë bimësie, që ushqehet nga ujërat nëntokësore.

Detet, liqenet dhe lumenjtë kryesorë

të Kazakistanit përfshijnë: liqenin Balkhash, liqenin Zajsan... lumin dhe grykën Çarin, lumenjtë Ili, Irtish, Ishim, Ural dhe Sirdarja... dhe Detin Aral, i cili vazhdimisht ka ardhur duke u tharë.

Deti Kaspik, që përfaqëson masën më të madhe ujore të brendshme, në botë, formon kufirin e Kazakistanit, me rreth 2333 km të vijës së tij bregdetare.

KLIMA

K l i m a e Kazakistanit është shumë kontinentale, ku verat e nxehta alternohen me dimra po aq ekstremë, veçanërisht në fusha dhe në luginat. T e m p e r a t u r a t luhaten gjerësisht me ndryshime të mëdha ndërmjet nënrajoneve. T e m p e r a t u r a t mesatare të janarit, në rajonet veriore dhe qendrore, variojnë nga -19 deri në -16 °C. Në jug temperaturat janë më të buta, duke filluar nga -5 deri në -1.4 °C. Temperaturat mesatare të Korrikut, në veri, arrijnë në 20 °C, kurse në jug ato rriten në 29 °C. Në vend reshjet variojnë nga 200 - 300 ml në vit, në rajonet veriore dhe qendrore, që shkojnë deri në 400-500 ml, në luginat malore jugore.

EKONOMIA

Ekonomia e Kazakistanit është më e madhja në Azinë Qendrore, në terma absolut dhe për frymë. Ajo posedon rezerva naftë, minerale dhe metale. Ajo gjithashtu ka një potencial të konsiderueshëm bujqësor, me stepat e saj të mëdha, që mundësojnë zhvillimin e blegtorisë dhe të prodhimit të drithit. Malet në jug janë të rëndësishme për mollët dhe arrat, dy lloje pemësh frutore që rriten atje në gjendje të egër. Sektori industrial i Kazakistanit mbështetet në nxjerrjen dhe përpunimin e këtyre burimeve natyrore.

Eksportet kryesore të vendit përfshijnë produkte bujqësore, lëndë të para, produkte kimike dhe mallra të përpunuara. Privatizimi i industrive shtetërore u ndërмор gjatë viteve

1990. Në vitin 1994 Kazakistani, Uzbekistani dhe Kirgistani formuan një bashkim ekonomik, të cilit më vonë iu bashkua Taxhikistani (në vitin 1998), bashkim i cili mundësoi lëvizjen e lirë të punës dhe kapitalit midis vendeve, dhe u vendosën politika ekonomike të koordinuara. Ky bashkim, gradualisht ia la vendin atij që më vonë u bë 'Unioni Ekonomik Euroaziatik', i përbërë nga Kazakistani, Rusia, Bjellorusia, Armenia dhe Kirgistani.



GJUHA

Kazakistani është zyrtarisht një vend dygjuhësh. Gjuha Kazake, (pjesë e familjes së gjuhëve turke Kipçak) flitet nga 64.4% e popullsisë, dhe ka statusin e gjuhës shtetërore, ndërkohë që rusishtja, e cila flitet nga shumica e kazakëve, është e shpallur si gjuha zyrtare, dhe përdoret në biznes, qeveri dhe komunikimin ndëretnik. Megjithatë, gjuha Kazake është duke e zëvendësuar gradualisht rusishten.

FEJA

Islami është feja e pjesës më të madhe të popullsisë në Kazakistan. Sipas regjistrimit të vitit 2009, numri i muslimanëve në Kazakistan është 70.19 %. Shumica e kazakëve janë muslimanë sunitë, ndjekës të shkollës Hanefi. Pastaj, nga pjesa tjetër e mbetur e popullsisë, 26 % e tyre identifikohen si të krishterë, 0.2 % budistë, dhe pjesa e mbetur u përkasin feve dhe besimeve të tjera (si hebrej, etj).

HISTORIA

Emri Kazakistan, me të cilin quhet ky vend, sipas gjuhës së vendasve, do të

thotë "Toka e endacakëve".

Kazakistani ka qenë i banuar që nga epoka e Paleolitit. Territori i Kazakistanit ishte një pjesë përbërëse kyçe e rrugës tregtare të stepës euroaziatike, që ishte paraardhëse e Rrugës së Mëndafshit. Sipas historianëve, gjatë kohëve të fundit parahistorike, Azia Qendrore mund të ketë qenë e banuar nga grupe të tilla si ato të kulturës Indo-Evropiane Afanasievo, nga kulturat e hershme indo-iraniane si Andronovo, dhe më vonë nga indo-iranianët, si grupet Saka dhe Massagetae. Grupe të tjera përfshinin Skitët nomadë dhe Perandorinë Persiane Akamenide në territorin jugor të Kazakistanit të sotëm.

Rreth fillimit të shekullit të 11-të, në stepat e Kazakistanit të sotëm hynë Kumanët, që më vonë u bashkuan me Kipçakët, dhe krijuan konfederatën e madhe Kuman-Kipçak. Megjithëse qytetet e lashta Taraz dhe Hazrat-Turkistan kishin shërbyer për një kohë të gjatë si stacione të rëndësishme rrugore përgjatë Rrugës së Mëndafshit, e cila lidhte Azinë me Evropën, konsolidimi i vërtetë politik i rajonit filloi vetëm me sundimin mongol, në fillimin e shekullit të 13-të. Në Perandorinë Mongole, atje u krijuan rrethet e para administrative të strukturuar në mënyrë të disiplinuar. Pas ndarjes së Perandorisë Mongole (në vitin 1259), toka që do të bëhej Kazakistani i sotëm, u sundua nga Kanati i Hordhisë së Artë (Fisit të Artë). Gjatë periudhës së Hordhisë së Artë, në elitën sunduese u shfaq një traditë turko-mongole, ku pasardhësit e turqizuar të Xhengiz Han ndoqën Islamin, dhe vazhduan të mbretërojnë mbi ato toka.

Në shekullin e 15-të, midis fiseve turke filloi të shfaqej identiteti i veçantë Kazak. Kjo u pasua nga lufta për pavarësi e kazakëve, ku Kanati Kazak fitoi sovranitetin e tij nga Shejbanidët. Procesi u konsolidua nga mesi i shekullit të 16-të, me shfaqjen e gjuhës, kulturës dhe ekonomisë kazake. Megjithatë, rajoni vuante nga mosmarrëveshjet gjithnjë në rritje mes emirëve-prijësve vendas kazakë, dhe popujve fqinjë persisht-folës, në jug. Në kulmin e tij, Kanati Kazak do të sundonte pjesë të Azisë Qendrore dhe do të kontrollonte Kumaninë. Territorët e Kanatit Kazak do të zgjeroheshin thellë në Azinë Qendrore. Nga fillimi i shekullit të 17-të, Kanatit Kazak luftoi kundër influencimit të rivaliteteve fisnore, të cilat e kishin ndarë popullsinë në pjesë të mëdha, të mesme dhe të vogla.

Përçarja politike, rivalitetet fisnore

dhe venitja e rëndësishë së rrugëve tregtare tokësore midis lindjes dhe perëndimit, e dobësuan Kanatin Kazak. Megjithatë, fillimi i shekullit të 18-të shënoi zenitin e Kanatit Kazak. Gjatë kësaj periudhe, Hordhia e Vogël (pjesë e Kanatit Kazak) mori pjesë në luftën e viteve 1723–1730, kundër Kanatit Zungar, që u ndoq nga "Fatkeqësia e Madhe" e pushtimit të territoreve kazake. Nën udhëheqjen e Abul-Hajr Kan, kazakët korrën fitore të mëdha mbi Zungarët.

Në gjysmën e parë të shekullit të 18-të, Perandoria Ruse kishte ndërtuar Linjën Irtish, që konsistonte në ndërtimin e një sërë kalash dhe fortifikesash, për të parandaluar sulmet e Kazakëve dhe Oiratëve në territorin rus. Në fund të shekullit të 18-të, kazakët përfituan nga Rebelimi Pugaçev (i njohur edhe si Lufta e fshatarëve), i cili ishte i përqendruar në zonën e Vollgës, dhe sulmuan vendbanimet ruse dhe gjermane të Vollgës.

Në shekullin e 19-të, Perandoria Ruse filloi të zgjeronte ndikimin e saj në Azinë Qendrore, dhe Carët sunduan pjesën më të madhe të territorit që tani është Republika e Kazakistanit. Përpjekjet ruse për të imponuar sistemin e saj, ngjallën pakënaqësi tek populli kazak. Ajo kishte prishur stilin e jetesës tradicionale nomade dhe ekonominë e bazuar në blegtori, dhe njerëzit po vuanin nga uria, ndërkohë që disa fise kazake ishin asgjësuar plotësisht. Lëvizja kombëtare kazake, e cila filloi në fund të shekullit të 19-të, u përpoq të ruante gjuhën amtare dhe identitetin, duke bërë rezistencë ndaj përpjekjeve të Perandorisë Ruse për t'i asimiluar dhe mbytur ato.

Nga vitet 1890 e më vonë, një numër gjithnjë e më i madh kolonësh nga Perandoria Ruse filluan të kolonizojnë territorin e Kazakistanit të sotëm, në veçanti provincën Semireshi. Departamenti i Migracionit, i krijuar posaçërisht në Shën Petersburg, mbikëqyri dhe inkurajoi migrimin për të zgjeruar ndikimin rus në zonë. Gjatë shekullit të 19-të, rreth 400.000 rusë emigruan në Kazakistan, dhe rreth një milion sllavë, gjermanë, hebrenj dhe të tjerë, emigruan në rajon gjatë fillimit të shekullit të 20-të. Mes kazakëve dhe të ardhurve filloi konkurrenca për tokë

dhe ujë, gjë e cila shkaktoi pakënaqësi të madhe tek kazakët kundër sundimit kolonial, gjatë viteve të fundit të Perandorisë Ruse. Revolta e Azisë Qendrore që ndodhi në vitin 1916, ishte kryengritja më e rëndësishme atje. Kazakët sulmuan kolonët rusë dhe garnizonet ushtarake të tyre.

Pas rënies së qeverisë qendrore në Petrograd, në Nëntor të vitit 1917, kazakët (të cilëve atëherë në Rusi u referoheshin zyrtarisht si "kirgizë") përjetuan një periudhë të shkurtër autonomie, përpara se t'i nënshtroheshin përfundimisht sundimit të bolshevikëve komunistë. Më 26 Gusht të vitit 1920, u krijua Republika Sovjetike Autonome Socialiste e Kirgistanit (Kazakistanit), brenda Republikës Socialiste Federative Sovjetike Ruse.

Represioni sovjetik, së bashku me kolektivizimin e detyruar në fund të viteve 1920 -1930, solli zi buke dhe vdekje të mëdha në vend, gjë që çoi në trazira.

Më 5 Dhjetor 1936, Republika Socialiste Sovjetike Autonome Kazake u shkëput nga Republika Socialiste Federative Sovjetike Ruse dhe e krijoi Republikën Socialiste Sovjetike Kazake (por pjesë e Bashkimit Sovjetik). Për shkak të dekadave të privimit, luftës dhe zhvendosjes, deri në vitin 1959, kazakët ishin bërë pakicë në vend, që përbënin vetëm 30% të popullsisë, kurse rusët etnikë përbënin 43% saj.

Në Dhjetor të vitit 1986, në Almati u zhvilluan demonstrata masive nga kazakët e rinj etnikë, që protestonin kundër zëvendësimit të Sekretarit të Parë të Partisë Komuniste të SSR-së Kazakistanit, Din-Muhamed Konajev, me Genadi Kolbin, nga RSFSR-ja ruse. Trupat qeveritare i shtypën trazirat; disa persona u vranë dhe shumë demonstrues u burgosën. Në ditët në rënie të sundimit sovjetik, pakënaqësia vazhdoi të rritej

XHAMIA NUR-SULTAN, ASTANA





KRYEQYTETI, ASTANA

dhe gjeti shprehje nën politikën e moderuar të udhëheqësit sovjetik, Mihail Gorbaçov.

Më 25 tetor të vitit 1990, Kazakistani shpalli sovranitetin mbi territorin e tij, si një republikë brenda Bashkimit Sovjetik. Pas tentativës së dështuar të grushtit të shtetit të Gushtit të vitit 1991 në Moskë, Kazakistani shpalli pavarësinë më 16 dhjetor të vitit 1991, duke u bërë kështu republika e fundit sovjetike që shpalli pavarësinë, dhe udhëheqësi i epokës komuniste të Kazakistanit, Nursulltan Nazarabajev, u bë Presidenti i parë i vendit.

SI ERDHI ISLAMI NË KAZAKISTAN

Përhapja e Islamit në territorin e Azisë Qendrore dhe tokës së Kazakistanit, i përket shekujve 7-8, të erës sonë. Njohja e parë e banorëve të rajonit me Islamin ndodhi në vitet 670, kur atje u shfaqën thirrësit e parë muslimanë. Megjithatë, triumfi përfundimtar i Islamit në rajon ndodhi në mesin e shekullit të 8-të. Në vitin 751, në qytetin Atlaha, afër Tarazit, filloi një betejë mes kryekomandantit arab Zijad ibn Saalikh dhe komandantit kinez Gao Sianzhi, betejë e cila zgjati për shumë ditë. Trupat kineze u mposhtën plotësisht dhe u larguan nga Zhetisu dhe Turkistani Lindor. Fitorja e ushtrisë muslimane shënoi fillimin e pranimit të mësimave të Profetit Muhamed dhe të fesë e kulturës islame në të gjithë rajonin e Azisë Qendrore.

Përhapja e Islamit në territorin e Kazakistanit të sotëm ka qenë një proces që zgjati disa shekuj. Fillimisht, feja e re u përhap në rajonet jugore. Nga fundi i shekullit të 10-të, Islami ishte stabilizuar në mesin e popullsisë në Zhetisu dhe Sir-Darja. Në fillim të shekullit të 10-të, Islamin e pranoi themeluesi i dinastisë Karahanids Satuk, dhe djali i tij, Bogra-Khan Haroon Musa, e shpalli Islamin fe shtetërore, në vitin 960. Përhapja e Islamit në mesin e banorëve vendas u bë në mënyrë paqësore. Islami u pranua vullnetarisht nga përfaqësues të klasave dhe popujve të ndryshëm. Në

veprat letrare, dokumentet epike dhe historike, nuk janë dokumentuar raste të qëndrimit armiqësor ndaj Islamit.

Thirrja në fe që bënin muslimanët e asaj kohe, nëpërmjet bindjes dhe shembullit të mirë, mund të shërbejë sot si model i përkushtimit të njerëzve ndaj besimit. Islami, në Azinë Qendrore, u miratua përmes veprave të mira të atyre që ftonin në të.

Në fillim të shekullit të 13-të, përhapja e Islamit në Kazakistan u ngadalësua nga pushtimi mongol, i cili solli në Azinë Qendrore dhe Kazakistan grupe të reja dhe fise të ndryshme turke dhe mongole, me fetë e tyre tradicionale. Shumë qytete u shkatërruan, qendrat shkencore dhe kulturore u grabitën, xhamitë dhe medresetë u shkatërruan.

Më pas, vetë pushtuesit mongolë u konvertuan në Islam, dhe filluan të përdorin gjuhën turke. Kjo bëri që feja në të cilën kishte ftuar Profetit Muhammed, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, vazhdoi të përparonte në stepën nomade, duke tërhequr popullsi të reja drejt saj.

Pas pranimit të Islamit nga Hordhia e Artë, nën Khan Berke (1255–1266), dhe përqafimi i tij i mëvonshëm nga kanët Tudemengu dhe Uzbekë, pozicioni i Islamit u forcua mjaft. Në sundimin e Khan Uzbek (1312–1342) në Saraj (kryeqyteti i Hordhisë së Artë), funksiononin 13 xhami. Feja u bë një nga mjetet që siguronin unitetin e shoqërisë. Thirrja Islame filloi të përhapej nëpër fiset nomade, në stepat e rajonit të Vollgës dhe Azisë Qendrore, ku shkuan thirrës nga pjesë të ndryshme të botës Islame.

Përhapja e shpejtë e Islamit midis fiseve nomade të Kazakistanit, kishte të bënte me faktin se besimi Islam përshtatej lehtësisht me traditat dhe zakonet kombëtare të popullit kazak. Islami ndikoi fuqishëm në shkrirjen e fiseve të ndryshme kazake në një grup të vetëm etnik.

Banorët e Khanatit Kazak ndoqën shkollën Hanefi të Islamit Sunit. Shtetësia e Kazakistanit, që nga fillimi i formimit të saj, u bazua mbi Ligjin - Sheriatin Islam. Përkushtimin ndaj Sheriatit e pretendonin të gjithë khanët kazakë, nga Kerej dhe Janibek, deri tek më i voni i khanëve kazakë, Khan Kenesary.

Në shekujt 16-17, përhapja e mëtejshme e Islamit në Kazakistan

kontribuoi në lidhjet intensive ekonomike dhe kulturore me kombet e Azisë Qendrore, kazakët dhe tatarët e Vollgës. Prijësit e Islamit ishin thirrës muslimanë nga Buhara, Samarkandi, Tashkenti, Khiva dhe Turkistani.

Gjatë shekullit të 18-të, ndikimi rus u rrit me shpejtësi në rajon. Rusët, të udhëhequr nga Perandoresha Katerina, fillimisht treguan gatishmërinë e tyre për të lejuar që Islami të lulëzonte, dhe klerikët muslimanë u ftuan në rajon për të predikuar mes kazakëve, të cilët rusët i konsideronin “të egër”, të paditur.

Por, politika ruse ndryshoi gradualisht drejt dobësimit të Islamit, duke futur elementë paraislamike në ndërgjegjen kolektive. Në përgjigje të kësaj, prijësit fetarë muslimanë kazakë, u përpoqën të nxinin entuziazëm fetar, duke përkrahur nacionalizmin turk, megjithëse shumë prej tyre, si rezultat, u persekutuan. Gjatë epokës sovjetike, sistemi komunist bëri përpjekje të mëdha për të futur ideologjitë komuniste tek popullsia kazake, dhe institucionet islame mbetën aktive vetëm në zonat ku kazakët ishin më të shumtë në numër sesa jomuslimanët.

Pas pavarësisë, Islami në Kazakistan u bë një forcë shoqërore me ndikim. Me kalimin e viteve vendi ka ndryshuar ndjeshëm numrin e komuniteteve muslimane. Nëse në vitin 1991 kishte vetëm 68 të tillë, në fillim të viteve 2000, numri i tyre arriti në 1652, kurse në vitin 2012, numri i komuniteteve muslimane u rrit në 2229. Në të gjithë vendin u ndërtuan xhami të reja. Sipas rezultateve të regjistrimeve, në vitin 2012 vendi kishte 2228 xhami.

XHAMIA “NUR-ASTANA”

Më 22 Mars të vitit 2005, në Astana (emri i vjetër i kryeqytetit të vendit, që tani quhet Nur-Sultan) u hap xhamia “Nur-Astana”, në të cilën mund të falin namazin deri në pesë mijë besimtarë. Kurse në vitin 2012, u hap xhamia më e madhe në vend, xhamia “Hazret Sulltan”, e cila është një nga ndërtesat më të bukura arkitekturore të kryeqytetit, që përfaqëson pasurinë shpirtërore të popullit të Kazakistanit. Kjo xhami është më e madhja në Azinë Qendrore, ku mund të falen deri në 10.000 besimtarë.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://www.worldometers.info>
<https://en.wikipedia.org/wiki>
<https://ar.wikipedia.org/wiki>
<https://www.britannica.com>
<https://www.marefa.org>
<http://edu.e-history.kz>

KUSH ISHTE SHEJH KËNALLËZADE ALI EFENDIU?

Më 6 Ramazan të vitit 979 hixhri (22 janar 1572 gregorian) në qytetin e Edrenesë ndërroi jetë hoxha i madh hanefi i Perandorisë Osmane, Ali Efendiu i njohur më shumë si Kënaallëzade dhe në arabisht si Ibën El-Hina.

Kush ishte shejh Kënaallëzade Ali Efendiu?

Sami Frashëri shënon se Kënaallëzade Ali Efendiu lindi në vitin 919 hixhri (1513 gregorian) në Isparta, nga një familje me formim të lartë arsimor, kulturor dhe fetar, bile babai i tij Israfil Emrullah Kënaallëzadeja ishte kadi i qytetit. Pas mësimave në shtëpinë dhe vatrën atërore ai udhëtoi për në Stamboll, kryeqendrën kulturore e shkencore të Perandorisë Osmane. Në Stamboll mësoi nga Meulana Ma'lul Efendiu, i cili ishte nxënësi i Ibën Kemal Pashës dhe Meulana Fenarit.

Pastaj këtu mësoi edhe nga Meulana Sinanudini, Merhaba Çelebiu si dhe nga i madhi Çivizade, myftiu i Stambollit dhe shejhulislami i Perandorisë Osmane. Shkollimi dhe mësimet e Stambollit e bënë atë shembull të shkëlqyer të një dijetari të mirëfillt të shkencave islame.

Shejh Kënaallëzade karakterizohej si personalitet shumë i virtytshëm, i sjellshëm dhe shumë i përsosur. Për shkak vazifes së myftiut ai pati udhëtuar në disa kryeqendra të botës islame, ku pati shërbyer myfti në Damask për katër vjet, pastaj në Kajro, Haleb, Bursa, Edrene dhe në Stamboll. Në fund u caktua kaziasker i tërë Anadollit. Ai njashtu pati punuar edhe mësues në disa medrese të çmuara në Bursa dhe në Stamboll si dhe në shkollën më të famshme të Stambollit, të njohur si "Sahn-i Seman". E si jo, kur ai ishte i një hoxhë i ditur në çdo shkeçë islame e sidomos në: fikh, tefsir, histori, filozofi, ahlak, poezi, etj. Poezitë e tij ishin në tri gjuhë: arabisht, osmanlisht dhe persisht.

Ai pas vetes la dy djem, të cilët edhe

ata ishin dijetarë dhe poetë. Ai njashtu pas vetes la edhe rreth 25 vepra, disa prej të cilave do të theksohen në vijim:

1. Tabekatu'l-hanefijeh. Vepër kronike e vogël e dijetarëve më të famshëm hanefi.

2. Hashijeh ale'd-Durar. Vepër e papërfunduar në stilin e shënimeve marginale fikhere mbi veprën e famshme të hanefive me titullin "Duraru'l-Hukam" të molla Husrevit.

3. Risaletun fi'l-Vakf. Trajtesë mbi rregullat e vakfit. Këtë vepër Ibën Abidini e citon disa herë në kapitullin e vakfit në Hashijen e tij.

4. Hashijeh ala Envani't-Tenzil. Vepër e papërfunduar në stilin e shënimeve marginale mbi Tefsirin e Bejdaviut.

5. Hashijeh ale'l-Keshaf. Vepër e papërfunduar në stilin e shënimeve marginale mbi Tefsirin e Zemeshheriut.

6. Ahlak Alaij. Vepër ahlaku në gjuhën turke të cilën e shkroi gjersa ishte në Damask.

7. Sherhu'l-Burdeh. Koment i poezisë së famshme "El-Burdeh".

8. Divani i poezive të tij. Etj.

Nxënësi më i dalluar i shejh Kënaallëzades padyshim se është imam Tumurtash Gaziu, autori i veprës "Tenviru'l-ebsar", vepër të cilën më vonë do ta komentojë Haskefu në librin e tij "Durru'l-Muhtar" dhe pastaj mbi këtë të fundit imam Ibën Abidini shkroi Hashijen e tij të famshme.

Më 6 Ramazan të vitit 979 hixhri, pas një infektimi që dyshohet se u helmua nga një mjek jomusliman ndërroi jetë dhe kështu një numër i madh veprash i mbetën pa përfunduar. Vdekja e tij ndodhi në Edrene, ku ndodhej në një shoqërim zyrtar të Sulltan Selimit.

Allahu e mëshiroftë dhe varrin e tij lule xheneti e bëftë!

Hazir D. Selmani, *Gostivar*

HATMEJA SHERIFE E RAMAZANIT, MIRËSI DHE BEKIM PËR BESIMTARËT



Ditën e mërkurë, më 27 prill 2022, pas namazit të iqindisë, në praninë e shumë besimtarëve dhe besimtarëve, në xhaminë e Parrucë u zhvillua ceremonia e mbylljes së Hatmes Sherife të Ramazanit.

Leximi i plotë i Kuranit Famëllartë, i quajtur ndryshme Hatmeja Sherife, tashmë është bërë traditë e bukur dhe e përvitshme gjatë çdo muaji të Ramazani. Imamë të Shkodrës, hafizlerë mysafirë nga Turqia, si dhe shumë besimtarë dhe besimtare tubohen pas çdo namazi të iqindisë dhe lexojmë çdo ditë nga një xhyz prej Kuranit Famëllartë.

Tradita e bukur e leximit të plotë të Kuranit Famëllartë përfundon me ceremoninë e mbylljes së Hatmes Sherife, në vigjilje të Natës së Kadrit.

Pasi u krye falja e namazit të iqindisë, filloi programi me fjalën e hapjes nga teologu Lavdrim Hamja, i cili pasi falënderoi të pranishmit dhe dy hafizlerët e ardhur nga Turqia, H. Metin Sari dhe H. Xhelal Koca, foli mbi rëndësinë e leximit të Kuranit Famëllartë dhe pozitën e lartë dhe vendin e veçantë, që kanë lexuesit e Librit të Allahut.

Më pas, H. Naim Drijaj, imam i xhamisë së Parrucës, mbajti një bisedë të shkurtër rreth vlerës dhe mirësisë së Natës së Kadrit e rastit, teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave", i cili pasi falënderoi të pranishmit dhe dy hafizlerët nga Turqia, foli mbi rëndësinë e leximit të Kur'anit Famëllartë dhe lidhjen e fortë që duhet të ketë muslimani me Librin të Allahut.

Lutja e Hatmes Sherife u drejtua nga H. Metin Sari në gjuhën arabe dhe nga teologu Lavdrim Hamja në gjuhën shqipe.



IFTARET E VËLLAZËRISË ISLAME NË OBORRIN E XHAMISË PARRUCË

Një traditë e bukur i shtohet sivjet atmosferës së Muajit Ramazan në Shkodër. Iftaret e vëllazërisë islame do të zbkurojnë qendrën e qytetit Shkodër në këto netë të bekuara të Muajit të shenjtë.

Falë punës së palodhur të imamëve të xhamisë Parrucë, teologëve Durim Kasemi dhe Naim Drijaj, si dhe mbështetjes së bamirësve shkodranë, Myftinia Shkodër vlerësoi propozimin për të zhvilluar iftarët e hapura, syfret dhe pakot e iftareve për familje në nevojë përgjatë këtij muaji të begatë.

Projekti nisi natën e kaluar, ku Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti një ligjëratë para të rinjve të ftuar, duke spikatur vlerat e rinisë në Islam.

Ndërkohë, sot, të martën, më 5 prill 2022, pas ligjëratës së imamit të xhamisë Parrucë, teologut Naim Drijaj dhe namazit të akshamit me xhemat, të ftuarit e këtij iftari gjallëruan oborrin e



xhamisë Parrucë, duke ndarë mesazhet e vëllazërisë dhe harmonisë islame në mes vete.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu Sytari, ndër të tjera, dha mesazhet e harmonisë dhe vlerësoi atmosferën e dritshme të këtij Muaji të begatë.

Myftiu përsëriti thirrjen e tij për shenjtërimin e Muajit Ramazan, si dhe uljen e çmimeve dhe përhapjen e frymës së mëshirës dhe solidaritetit në mesin e njerëzve.

Myftinia Shkodër falënderon grupin e punës, të cilët punuan me përkushtim për realizimin e projektit të sofrës së iftarëve, ndër ta: H. Durim Kasemi, H. Ervil Kuçi, H. Naim Drijaj, H. Lavdrim

Hamja dhe z. Erion Llazani; edhe grupin e të rinjve: Lindi Barbullushi, Xhoel Mërkulaj, Muhamed Dyli, Rajan Dyli, Elvis Jukni, Elvis Çoku, Neval Uruçi, Semaldo Kasemi, Egest Arrila, Samuel Kasemi, Eugen Tërfoja, Dorian Paculi, Adenis Dumaj, Briseld Fyraj, Samed Hafizi, Jorgen Hjeksa, Ergi Hysa, Rei Kraja, Erikson Muça.



100 PAKOVE USHQIMORE PËR FAMILJET E LAGJES URA E BUNËS

Pas namazit të xhumasë, më 8 prill 2022, Myftinia Shkodër me mbështetjen e Shoqatës "Istanbul" bëri të mundur shpërndarjen e 100 pakove ushqimore për familjet e lagjes Ura e Bunës.

Imami i xhamisë tek Ura e Bunës, H. Ridvan Luzaku së bashku me rininë e xhamisë organizuan shpërndarjen e 100 pakove të Ramazanit për banorët e kësaj lagje, të cilë pothuajse janë harruar nga

institutet përgjegjëse.

Allahu i Madhëruar i shpërbleftë donatorët dhe secilin që ndihmon njerëzit dhe familjet në nevojë.

Muaji i Ramazanit është muaji i solidaritetit dhe i ndihmës, dhe me këtë rast Myftinia Shkodër i bën thirrje biznesmenëve dhe njerëzve të pasur, të kontribuojnë për familjet e varfra dhe në nevojë.



SOFRA E IFTARIT STACIONOHET NË QENDRËN KULTURORE BARBULLUSH

Ditën e shtunë, më 09 prill 2022, në ditën e 8-të të muajit të Ramazanit, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit organizoi një iftar më nxënësit e mejtepeve/kurseve fetare që zhvillohen në qendrën kulturore, pranë xhamisë Barbullush.

Në këtë iftar, përveç 55 nxënësve të niveleve të ndryshme të mejtepeve, imamit dhe mësuesit të mësim-besimit, Elvis Molla mori pjesë drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili në një bisedë të shkurtër përpara çeljes së iftarit, falënderoi bamirësit islamë shkodranë, të cilët mbështetën nismën e Myftinisë Shkodër për të sjelle një atmosferë dhe traditë ndryshe nga vitet e



kaluara, pikërisht organizimin e iftareve të vëllazërisë, të mirësisë, solidaritetit dhe të afrimit sa më tepër me njeri-tjetrin për të ndarë begatitë e Zotit që zbresin në mënyrë të veçantë për besimtarët dhe agjëruarit në këtë muaj të shenjtë Ramazanit.

Në fund të iftarit, imami i xhamisë së



Barbullushit, bëri dua-lutjen si dhe më pas të gjithë të pranishmit falën bashkërisht namazin e akshamit.

Projekti i sofrës së iftareve të vëllazërisë do të vijojë edhe në disa xhami dhe qendra të tjera islame, të rrethit të Shkodrës.

SOFRA E HAPUR E IFTARIT NË XHAMINË E "DY VAJZAVE"



Sofra e hapur e iftarit, ditën e mërkurë, më 13 prill 2022, u ndal në xhaminë e "Dy Vajzave".

Në këtë sofër të begatë iftari, të shtruar nga Myftinia Shkodër me Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam, merrnin pjesë xhemati i xhamisë, imamë të nderuar dhe intelektualë të Shkodrës.

Pas çeljes së iftarit në xhami, u bë falja e namazit të akshamit me xhematë, nën drejtimin e imamit Lavdrim Hamja.

I pranishëm në këtë iftar ishte edhe përfaqësuesi i AIITC-së, teologu Genc Aga, i cili uroi agjëruarit dhe bëri lutje, që Allahu ta pranojë agjërimin dhe krejt adhurimet e tjera.

Teologu Lavdrim Hamja falënderoi AIITC-së për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë për xhaminë e "Dy Vajzave".



MYFTIU SYTARI: "KOHA PËR TA KTHYER KURANIN NË JETËN TONË!"



Me ftesë të Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti të Kosovës, H. Husamedin ef. Hoxha, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, udhëtoi të enjten, më 14 prill 2022 drejt Kosovës, për të marrë pjesë në aktivitetin e KBI të Vitisë me rastin e Muajit Ramazan.

Pas bashkëbisedimit të përzemërt me Kryetarin e KBI Viti, H. Husamedin ef. Hoxha, Myftiu dhe mikpritësi i tij me bashkëpunëtorë, u drejtuan nga salla e madhe e Shtëpisë së Kulturës së qytetit, ku u zhvillua edhe aktiviteti në fjalë.

Në ligjëratën e tij, Myftiu i Shkodrës, hodhi dritë mbi vlerën dhe pozitën e Kuranit në jetën e muslimanëve, si dhe domosdoshmërinë për të reflektuar në marrëdhënien tonë me Librin e Allahut, për të gjetur mënyrat e shkëputjes së lidhjeve folklorike me të!

Imam Muhamed B. Sytari tha ndër



të tjera se duhet patjetër të shkëputemi nga trajtimi mitologjik dhe folklorik që i bëjmë Kuranit, për të rikthyer në punë mendimin dhe përkushtimin me vetëdije ndaj thelbit të kuptimeve të Kuranit, për ta rikthyer dritën e tij në realitete të jetuara në mes nesh!

Myftiu u lut edhe për gjallërimin e mëtejshëm të aktivitetit fetar e kombëtar, që ka për qëllim promovimin e vlerave më të mira që na bëjnë të jetojmë me dinjitet dhe si mëkëmbës të Zotit në tokë.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu Sytari u takua edhe me kryetarët e KBI të qyteteve Ferizaj dhe Kaçanik, me të cilët këmbëu mendime për domosdoshmërinë e rritjes së bashkëpunimit në të mirë të besimtarëve dhe bashkësive përkatëse.

Ligjëratë e Myftiut të Shkodrës dhe krejt aktiviteti u përcoll edhe nga Plus Televizion.



SOFRA E IFTARIT ME NXËNËSIT E MEJTEPIT TË XHAMISË DHE QENDRËS KULTURORE, OBLIKË



Ditën e hënë, më 18 prill 2022, në ditën e 17-të të muajit të Ramazanit, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit organizoi iftarin e radhës me nxënësit e mejtepeve/kurseve fetare që zhvillohen, pranë xhamisë dhe Qendrës Kulturore, Oblikë.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së rreth 60 nxënësve të niveleve të ndryshme të mejtepeve, imamit Nadi Braçi dhe mësueses të mësim-besimit, znj. Kimete Elezi mori pjesë drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, u mbajt një bisedë të shkurtër me këshilla të dobishme, ku vuri në dukje



se prezenca e fëmijëve dhe e të rinjve në sofrat e iftarit, në faljen e namazeve të teravive, në mexhliset e këndimit të Kur'anit Famëlartë dhe të mësim-besimit, është pa dyshim një tregues i dalluar i një vitaliteti dhe gjallërie që ata japin në këtë muaj të shenjtë Ramazanit.

Në fund të iftarit, imami i xhamisë dhe mësuesja e kurseve fetare, bënë dua-lutjen si dhe më pas të gjithë të pranishmit falën bashkërisht namazin e akshamit.

Projekti i sofrës së iftareve të vëllazërisë do të vijojë edhe në disa xhami dhe qendra të tjera islame, të rrethit të Shkodrës.



SOFRA E IFTARIT ME NXËNËSIT E MEJTEPIT TË XHAMISË SHIRQ-MUSHAN



Ditën e shtunë, më 23 prill 2022, në ditën e 22-të të muajit të begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit organizoi iftarin e radhës me nxënësit e mejtepit/kurseve fetare që zhvillohen, pranë xhamisë Shirq-Mushan, Njësia Administrative Dajç.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes

së rreth 45 nxënësve të moshave të ndryshme të mejtepit, imamit dhe mësuesit të devotshëm, H. Kujtim Cufaj, mori pjesë edhe drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, përmes një bisedë të shkurtër u dha nxënësve disa këshilla të dobishme edukative dhe besimore.



XHAMIA E FUSHË ÇELËS, PRANVERË RAMAZANI!

Që nga fillimi i muajit Ramazan, pastrimet dhe sistemimet e vakëfit të Fushë Çelës nuk janë ndërprerë.

Atmosfera e begatë e këtij Muaji i ka angazhuar të gjithë në drejtim të mirëmbajtjes dhe sistemimit të oborrit dhe anekseve të xhamisë së madhe "Ebu Bekër", në Shkodër.

Angazhimet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e oborreve të xhamive, janë pjesë e përpjekjeve për të ruajtur



ritmet e të parëve, që përhapen kudo gjurmët e qytetërimit islam, ku përkujdesja për gjelbërimin, mbjelljen e pemëve, shatërvanët, vijat e ujit për kafshët, zogjtë dhe shpendët, ishte dhe ngeli një amanet i trashëguar nga porositë e të dërguarit të Allahut, Hz. Muhamedit (a.s.).

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë ata që përkujdesen për gjelbërimin e xhamive, mirëmbajtjen e tyre dhe rritjen e ndjeshmërive ndaj higjienës dhe pastërtisë në xhamitë tona.

Në fund të iftarit, imami i xhamisë, bëri duan e iftarit si dhe më pas të gjithë të pranishmit falën bashkërisht namazin e akshamit, i cili përfundoi me salavate, dhikër, lutje, etj.

Programi i sofrës së iftareve të vëllazërisë do të vijojë edhe në disa xhami të tjera të Shkodrës.



MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË DISA XAMI SHQIPTARE NË GJERMANI



Mannheim



Ludwigshafen



Karlsruhe

Me ftesë zyrtare të Bashkësisë Islame Shqiptare në Ludwigshafen të Gjermanisë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në disa aktivitete të larmishme fetare në disa xhami dhe qendra islame shqiptare në Karlsruhe, Mannheim dhe Ludwigshafen, në datat 21-24 prill 2022.

Myftiu mbajti ligjëratën para xhumasë

dhe hytben e asaj dite në xhaminë e re shqiptare në Karlsruhe. Më pas, ligjëroi në xhaminë e shqiptarëve në Mannheim dhe takimin me pyetje-përgjigje, sikurse ligjëroi edhe në xhaminë shqiptare në Ludwigshafen, ku mori pjesë edhe në tribunën fetare, me ç'rast iu përgjigj edhe pyetjeve dhe interesimit për aktivitetin e Myftinisë Shkodër dhe zhvillimet e ndryshme të Thirrjes Islame në Shkodër e Shqipëri.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu vizitoi edhe xhaminë e madhe të Dijanetit të Turqisë në qytetin e Mannheinit, sikurse u takua edhe me imamë dhe aktivistë të zellshëm në këto qytete.

Imam Muhamed B. Sytari e shprehu një pjesë të emocioneve dhe përshtypjeve të tij nga ky udhëtim edhe nëpërmjet video-mesazheve të pasqyruara në kanalën e tij në youtube.



Mannheim



Ludwigshafen

MYFTINIA SHKODËR SHPËRNDAN PAKON USHQIMORE TË RAMAZANIT PËR PARATETRAPLEGJIKËT DHE FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA



Ditën e hënë paradreke, më 25 prill 2022, Myftinia Shkodër shpërndan pakon ushqimore të Ramazanit për para-tetraplegjikët dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në këtë ditë të Ramazanit, u bë shpërndarja e rreth 100 pakove ushqimore për personat para-tetraplegjikë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Këto pako janë fryt i bashkëpunimit, tashmë të përvitshëm me Helpin Hand for Relief and Development, USA, përmes së cilës këtë vit kemi siguruar 250 pako ushqimore të Ramazanit, që do t'u shpërndahen njerëzve dhe familjeve në nevojë.

Myftinia Shkodër falënderon shoqatat dhe fondacionet e ndryshme, që kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë me projekte të larmishme bamirëse gjatë Ramazanit, por jo vetëm.



“RIMËKËMBJA E VIRTYTEVE” MBYLLET ME SUKSES CIKLI I EMISIONEVE ME RASTIN E TRE MUAJVE TË MIRË

Myftinia Shkodër në kuadër të Tre Muajve të Mirë (Rexhep, Shaban dhe Ramazan) organizoi një cikël të emisioneve me tematikë “Rimëkëmbja e Virtyteve”, të cilat u transmetuan në rrjetet sociale të Myftinisë Shkodër, facebook dhe youtube, në emisionin “Ramazani midis nesh” në Tv1 Channel si dhe në programin “Jehonë Ramazani”, në Radio Jehona.

Në këto emisione me përmbajtje fetare-educative, të drejtuar nga teologu Arben Halluni dhe në të cilat janë zhvilluar bashkëbisedime, intervista dhe pasqyrim të hytbeve të xhumave kanë qenë të ftuar dhe ligjërues: Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, imamët; Lavdrim Hamja, Ervil Kuçi, Naim Drijaj, Durim Kasemi, Adil Cukali, Altin Nikshqi, Besim Barbullushi, Idmir Plaku dhe Adem Pizga, si dhe teologët; Ferzet Ndoja, Jetmira Plaku dhe Zamira Bushati.



NATA E KADRIT, MË E MIRË SE NJË MIJË MUAJ!



Nata e 27-të e Ramazanit, që është Nata e Kadrut, është nata më e mirë se një mijë muaj. Si çdo vit, ashtu edhe këtë Ramazan, Myftinia Shkodër organizoi ditën e mërkurë, më 27 prill 2022 një program të larmishëm me rastin e kësaj Nate të Begatë e mbushur me plot mirësi e bekime nga Zoti (xh.sh). Ky program nisi që me namazin e iqindisë, ku u mbyll edhe Hatmeja e plotë e leximit të Kuranit Famëllartë dhe dua ja e saj.



Në mbrëmje, pas faljes së farzit të jasisë, në xhaminë e Parrucës, që ishte mbushur plot me besimtarë, H. Naim Drijaj, imami i xhamisë së Parrucës, mbajti një ders të veçantë rreth vlerave dhe mirësive të kësaj Nate të Begatë, që është Nata e Kadrut.

Programi vazhdoi me faljen e namazit të teravisë nga disa imamë dhe gjithashtu nga hafizlerët nga Turqia, të ardhur enkas për këtë Ramazan.

Kjo natë u zbulua nga leximi i Kurani nga hafizët turq, dhikret, salavatet, dua ja dhe në fund me faljen e namazi të vitrit, duke mbyllur kështu programin e Natës së Kadrut.

IFTARI I FAMILJES MBYLL IFTARET E VËLLAZËRISË ISLAME



Të shtunën, më 30 prill 2022, në lulishten pranë xhamisë “Ebu Bekër”, Fushë Çelë, Myftinia Shkodër organizoi iftarin e madh të familjes përmblylës me moton “Ramazani, muaji i familjes”, ku morën pjesë rreth 500 vetë.

Pas këndimit të ezanit të akshamit, nga teologu Alban Kali, u bë çelja e iftarit përmes një dua-mesazhi nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili gjatë përshëndetjes tha: “Pa dyshim ky iftar është një përjetim i mrekullueshëm, një mbyllje e denjë për Ma të Mirin e

muajve, në zemër të Shkodrës!

Mirënjohje dhe falënderim për krejt pjesëmarrësit, në këtë risi “Iftari i Familjes”, ku fytyrat e qeshura të fëmijëve, razilleku i prindërve dhe përkushtimi i një Muaji të begatë, na dhurojnë emocione të papërshkrueshme”.

Më pas të gjithë të pranishmit shijuan iftarin e vëllazërisë dhe harmonisë familjare, duke i dhënë një përmblyllje madhështore atmosferës së begatë të Ramazanit.

“Iftari i Familjes” përfundoi me faljen e namazit të akshamit me xhemat.



Falënderim dhe mirënjohje!

Myftinia Shkodër shpreh falënderimet e saj më të përzemërta për kontribuuesit e devotshëm, që iu gjenden pranë, në periudhën e vështirë të pandemisë globale, si dhe me rastin e muajit të madhërishëm të Ramazanit, duke bërë që projektet bamirëse të Myftinisë Shkodër të përfshinin një numër të madh dhe të konsiderueshëm familjesh në nevojë.

All-llahu ia shpërbleftë me mirësitë e Tij në pakufishme.

NË VEÇANTI:

- Qendrës Humanitare Bamirëse "Mbreti Selman", Arabia Saudite
- Helpin Hand for Relief and Development, SHBA
- Shoqata Bamirëse "VATAN", Zvicër
- Shoqata "Istanbul", Shkodër
- Bashkësia Islame Shqiptare Wil, Zvicër
- Bashkësia Islame Shqiptare Ludwigshafen, Gjermani
- Xhamia "Dituria", Gjenevë
- Fondacioni "Mirësia", Tiranë
- Fondacioni "Mirënjohja", Tiranë
- Biznesmenë dhe bamirës të ndryshëm nga SHBA, Gjermania, Zvicra, Italia, etj, si dhe nga Shkodra, të cilët preferuan të ngelen anonimë
- Mediat lokale në Shkodër, TvI-Channel, Star Plus Tv, Rozafa Tv, Radio Jehona, etj.

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org